

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
“PËR
MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR PËR PËRSHTATJEN NDAJ
NDRYSHIMEVE KLIMATIKE 2026-2036”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036 (NAP)” synon të krijojë kuadrin e nevojshëm strategjik dhe institucional për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e masave për rritjen e qëndrueshmërisë së vendit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike. Ky projektakt përmbush kërkesat e pikës 7 të nenit 5 të ligjit nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, të ndryshuar si dhe angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), Marrëveshjes së Parisit dhe procesit të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht në fushën e përshtatjes dhe planifikimit klimatik me Rregulloren e (BE) 2021/1119 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 30 qershor 2021, që përcakton kornizën për arritjen e neutralitetit klimatik dhe ndryshon Rregulloret (KE) nr. 401/2009 dhe (BE) 2018/1999 (‘Ligji Evropian për Klimën’) i cili parashikon dispozita më të forta mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Miratimi i NAP-it synon të vendosë një bazë të qëndrueshme politike dhe teknike që i mundëson institucioneve qendrore dhe vendore të identifikojnë, prioritojnë dhe zbatojnë masa të përshtatjes të cilat janë identifikuar bazuar në evidenca shkencore, analiza të rrezikut klimatik dhe nevojat specifike të sektorëve të ndjeshëm. Përmes këtij projektvendimi forcohet gjithashtu bashkërendimi ndërinstitutional dhe rritet kapaciteti i administratës publike për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e progresit të masave të përshtatjes në nivel kombëtar dhe vendor.

Qëllimi kryesor i projektvendimit është reduktimi i ndikimeve të lidhura me ndryshimet klimatike në mbarë vendin, përmes forcimit të kapaciteteve institucionale dhe teknike që mbështesin integrimin e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) në planifikimin afatmesëm dhe afatgjatë.

Projekt-vendimi synon funksionalizimin e një procesi të unifikuar, gjithëpërfshirës dhe afatgjatë të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, i cili mundëson:

- vlerësimin sistematik të rreziqeve dhe cenueshmërisë klimatike për sektorët prioritarë;
- orientimin e politikave dhe investimeve publike drejt reduktimit të rrezikut dhe rritjes së elasticitetit klimatik;
- rritjen e koherencës ndërmjet politikave zhvillimore, planifikimit hapësinor dhe buxhetimit të projekteve të përshtatjes;
- përmirësimin e koordinimit ndërinstytucional dhe forcimin e kapaciteteve për përmbushjen e detyrimeve të raportimit kombëtar dhe ndërkombëtar;
- integrimin e përshtatjes në nivel vendor, përmes planeve dhe programeve të zhvillimit lokal.

Nëpërmjet këtij projektvendimi synohet të arrihen objektivat kryesorë:

1. **Miratimi i një dokumenti kombëtar**, që përcakton vizionin, qëllimet, prioritetet dhe masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për periudhën afatmesme dhe afatgjatë.
2. **Përforcimi i kuadrit institucional**, duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe vendore në procesin e planifikimit dhe zbatimit të masave të përshtatjes.
3. **Integrimi i përshtatjes në politikat sektoriale dhe vendore**, përmes harmonizimit të NAP-it me dokumentet e planifikimit strategjik, zhvillimit rajonal, menaxhimit të riskut, planifikimit hapësinor dhe strategjive sektoriale.
4. **Forcimi i mekanizmave të monitorimit, raportimit dhe vlerësimit (MRV)** për masat e përshtatjes, në përputhje me kërkesat e UNFCCC, Marrëveshjes së Parisit dhe Kornizës së Transparencës së Përmirësuar.
5. **Rritja e ndërgjegjësit, pjesëmarrjes dhe kapaciteteve të aktorëve institucionalë, komunitarë dhe privatë** në procesin e përshtatjes, me fokus te qasja gjithëpërfshirëse dhe reduktimi i pabarazive.
6. **Nxitja e aksesit në financim për masat e përshtatjes**, duke orientuar institucionet drejt burimeve ndërkombëtare të financimit klimatik dhe integrit të kostove të përshtatjes në buxhetimin publik.

Ky projektvendim përbën një hap thelbësor për rritjen e qëndrueshmërisë së vendit ndaj rreziqeve klimatike, duke garantuar një qasje të strukturuar, të koordinuar dhe të bazuar në prova shkencore për mbrojtjen e komuniteteve, infrastrukturës dhe burimeve natyrore të Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTËVE DHE DOKUMENTË TË TJERA POLITIKË

Miratimi i këtij projektvendimi është i parashikuar në programin analitik të akteve të Ministrisë së Mjedisit për vitin 2026 dhe përputhet plotësisht me prioritetet e Programit Politik të Këshillit të Ministrave, i cili thekson rëndësinë e forcimit të qëndrueshmërisë së vendit ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe avancimit drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Projektvendimi kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e objektivave qeveritare për konsolidimin e politikave mjedisore, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe integrimin e politikave të klimës në sektorët prioritarë të zhvillimit.

Ky projektvendim është në përputhje me detyrimet që burojnë nga Ligji nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, i ndryshuar i cili parashikon hartimin dhe miratimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes si një instrument strategjik kombëtar për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe zvogëlimin e cenueshmërisë së sektorëve të ndjeshëm.

Projektvendimi është gjithashtu tërësisht i harmonizuar me dokumentet kryesore të planifikimit kombëtar, si një nga shtyllat prioritare të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2030, Strategjia e Reduktimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030, si dhe në përputhje me Agjendën e Gjelbërt të Ballkanit Perëndimor. Miratimi i NAP-it përmbush objektivat e këtyre politikave duke vendosur një kuadër të qartë veprimi për reduktimin e rrezikut klimatik dhe orientimin e investimeve drejt qëndrueshmërisë dhe përshtatjes klimatike.

Në kuadër të procesit të integritetit evropian, projektvendimi kontribuon në procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat e Rregullores së Bashkimit Evropian për Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën (Rregullorja BE 2018/1999), e cila vendos detyrim për shtetet anëtare dhe vendet candidate për të hartuar plane kombëtare të përshtatjes dhe për të ngritur mekanizma efektivë monitorimi dhe raportimi. Po ashtu, PKP-ja kontribuon në përmbushjen e kërkesave për kapitullin 27 – Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike në procesin e negociatave të Shqipërisë me BE-në.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shqipëria, për shkak të pozicionit të saj bregdetar në Evropën Jugore dhe rrethanave socio-ekonomike e institucionale, është veçanërisht e ekspozuar ndaj rreziqeve klimatike. Parashikimet tregojnë rritje të vazhdueshme të temperaturave, ulje të reshjeve, shtim të fenomeneve ekstreme të motit dhe pasoja të dukshme nga rritja e nivelit të detit, veçanërisht përgjatë bregdetit të Adriatikut. Këto zhvillime kërcënojnë komunitetet, infrastrukturën dhe ekosistemet, duke nënvizuar nevojën urgjente për planifikim të koordinuar dhe multisektorial të përshtatjes. Për këtë arsye, adaptimi është tashmë një domosdoshmëri për të menaxhuar rreziqet dhe për të garantuar funksionimin afatgjatë të sistemeve natyrore, sociale dhe ekonomike.

Në këtë kuadër është përgatitur Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (2026–2036), si një kuadër strategjik që udhëheq përpjekjet kombëtare për të ndërtuar aftësinë ripërtëritëse ndaj klimës në vend përmes një sërë masash për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Plani është hartuar përmes një procesi të gjerë konsultimesh dhe analizash të udhëhequr nga Ministria e Mjedisit, me mbështetjen e UNDP dhe Fondit të Gjelbër për Klimën, dhe sipas metodologjive të UNFCCC.

Procesi u fokusua në pesë sektorë kryesorë—Bujqësi & Pyje, Zhvillim Urban, Turizëm, Energji dhe Transport—të cilët u analizuan në mënyrë të thelluar për riskun dhe vulnerabilitetin duke përdorur metodologjitë e IPCC. Analizat treguan rritje progresive të rreziqeve klimatike në të gjitha sektorët, duke theksuar domosdoshmërinë e veprimit të menjëhershëm. Në këtë kuadër mbi bazën e një Analizë me Shumë Kritere (MCA) u prioritzuan 66 masa adaptimi, ndërsa për 21 masa infrastrukturore—green dhe grey—u krye Analizë Kosto-Përfitim (CBA) bazuar në metodologjitë e Komisionit Evropian, mjetin CPAT të FMN/Bankës Botërore dhe literaturën shkencore.

Ky proces i bazuar në të dhëna synoi të mbështesë institucionet qendrore në identifikimin dhe prioritarizimin e ndërhyrjeve, duke krijuar bazën për Planin Kombëtar të Përshtatjes 2026-2036 (NAP) dhe instrumentet zbatuese të tij:

- Planin e Veprimit të NAP-it
- Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore
- Planin e Komunikimit dhe Angazhimit të Palëve të Interesit
- Strategjinë Financiare të NAP
- Kornizën e Monitorimit, Vlerësimit dhe Raportimit të NAP-it

Hartimi dhe miratimi i këtij projektvendimi është një kërkesë ligjore dhe politike, në përputhje me ligjin nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”, i ndryshuar i cili përcakton NAP-in si instrumentin qendror strategjik për menaxhimin e rreziqeve klimatike. Deri më sot, procesi i adaptimit ka qenë i fragmentuar, pasi nuk ekzistonte një plan kombëtar i dedikuar dhe përshtatja ishte trajtuar vetëm përmes një Plani Veprimi të integruar në Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike.

Plani Veprimi i vitit 2019, me 15 masa prioritare ndërsektoriale, synoi të hidhte bazat e para të procesit të përshtatjes përmes forcimit të kapaciteteve institucionale, integrimin në politikat publike dhe përmirësimit të infrastrukturës kritike. Megjithatë, mungesa e një dokumenti gjithëpërfshirës kombëtar kufizoi koordinimin ndërinstitutional dhe harmonizimin e ndërhyrjeve sektoriale, sidomos në sektorët e bujqësisë, energjisë, ujërave, turizmit, infrastrukturës, zhvillimit urban dhe ekosistemeve natyrore.

Procesi i hartimit të NAP-it, i nisur në korrik 2021, synon të adresojë këto boshllëqe. Projektvendimi vendos një kornizë të qartë strategjike dhe teknike për identifikimin, planifikimin dhe zbatimin e masave të përshtatjes në nivel kombëtar dhe vendor, duke krijuar mekanizma të unifikuar për monitorim, raportim dhe vlerësim. Deri tani, mungesa e një sistemi të tillë ka vështirësuar përmbushjen e detyrimeve sipas UNFCCC-së, Marrëveshjes së Parisit dhe Kornizës së Transparencës, si dhe ka kufizuar qasjen në fondet ndërkombëtare të përshtatjes.

Projektvendimi sjell disa avantazhe kyçe:

1. Vendos një orientim të qartë strategjik për gjithë ciklin e planifikimit të përshtatjes, bazuar në analiza shkencore të riskut dhe vulnerabilitetit.
2. Forcon koordinimin ndërinstitutional, duke qartësuar rolet e ministrive, agjencive ekzekutive dhe njësive të qeverisjes vendore, si dhe duke harmonizuar ndërhyrjet sektoriale.
3. nxit përdorimin e analizave të rrezikut dhe cënueshmërisë si bazë për politikat;
4. Përmirëson aksesin në financime ndërkombëtare, pasi struktura e NAP-it përputhet me kërkesat e GCF, IPA dhe instrumenteve të tjera financiare, duke e bërë më të lehtë argumentimin e investimeve të përshtatjes.
5. Mbështet përafrimin me acquis të BE-së, veçanërisht me Rregulloren (BE) 2018/1999 për Qeverisjen e Energjisë dhe Klimës, e cila kërkon planifikim të qëndrueshëm dhe sisteme transparente monitorimi e raportimi.

6. Siguron një bazë të fortë teknike për planifikim afatgjatë, falë përdorimit të metodologjive të miratuara nga IPCC, UNFCCC dhe standardeve europiane të vlerësimit ekonomik.

Efektet e pritshme të projektaktit shfaqen në disa dimensione:

1. Efekte institucionale

- Përmirësim i kapaciteteve për vlerësimin dhe menaxhimin e rreziqeve klimatike.
- Koordinim më i mirë i politikave sektoriale.
- Përmbushje më e plotë e detyrimeve të raportimit ndërkombëtar.

2. Efekte ekonomike

- Orientim i investimeve publike dhe private drejt qëndrueshmërisë.
- Ulje e kostove nga ngjarjet ekstreme klimatike.
- Nxitje e investimeve të reja infrastrukturore, natyrore dhe sociale.

3. Efekte mjedisore dhe sociale

- Mbrojtje më e mirë e ekosistemeve, biodiversitetit dhe burimeve natyrore.
- Rritje e reziliencës së komuniteteve, sidomos të grupeve më vulnerabël.
- Zhvillim urban dhe territorial më i qëndrueshëm.

Sa i përket problematikave potenciale, projektvendimi nuk sjell kosto të menjëhershme të konsiderueshme dhe nuk krijon barrë administrative të panevojshme. Masat për dy vitet e para janë kryesisht masa “soft”, tashmë të integruara në Plan-Buxhetin Afatmesëm. Sfidat lidhen kryesisht me nevojën për forcim të kapaciteteve institucionale dhe teknike, veçanërisht në nivel vendor, dhe me sigurimin e burimeve për funksionimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit. Megjithatë, këto sfida trajtohen gjatë fazës së zbatimit, ndërsa projektvendimi ofron bazën e nevojshme për orientim politik dhe teknik afatgjatë.

Në përfundim, projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036” përfaqëson një hap të rëndësishëm strategjik për Shqipërinë, duke adresuar problematikat ekzistuese, duke shfrytëzuar përparësitë e krijuara nga procesi i NAP-it dhe duke prodhuar efekte të prekshme institucionale, ekonomike, mjedisore dhe sociale. Ai ofron një kornizë të domosdoshme për rritjen e qëndrueshmërisë së vendit ndaj ndryshimeve klimatike dhe për përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTËTUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektakt është përgatitur në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 155/2020, “Për Ndryshimet Klimatike”, ku neni 5 i tij parashikon *përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes si një instrument strategjik kombëtar për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe reduktimin e cenueshmërisë së sektorëve të ndjeshëm.*

Projektvendimi është në përputhje me parimet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht me detyrimin e shtetit për të garantuar zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtjen e mjedisit, administrimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së qytetarëve.

Projektakti harmonizohet plotësisht me kuadrin ligjor kombëtar në fuqi dhe dokumentet e tjera strategjike, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjinë për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe politikat sektoriale të zhvillimit si Strategjinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027, Dokumentin e Politikave Për Pyjet Në Shqipëri, Kontributin Kombëtar të Përcaktuar që kërkojnë integrimin e masave të përshtatjes. Miratimi i NAP 2026-2036 përputhet gjithashtu me parimet e përcaktuara në ligjin nr. 48/2018 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ligjin nr. 8756 “Për emergjencat civile”, si dhe në legjislacionin për turizmin, energjinë dhe transportin.

Në kuadër të harmonizimit me legjislacionin ndërkombëtar, projektaktit i jepet një rëndësi e posaçme, pasi është thelbësor për zbatimin të detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe Marrëveshjes së Parisit, të cilat kërkojnë nga palët hartimin e planeve kombëtare të përshtatjes, vlerësimin e rreziqeve klimatike, raportimin periodik të progresit dhe vendosjen e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të masave të përshtatjes. Projekti kontribuon gjithashtu në përmbushjen e kërkesave të Kornizës së Transparencës së Përmirësuar (ETF), duke siguruar dispozitat për ngritjen e një sistemi të konsoliduar të monitorimit dhe raportimit në linjë me udhëzimet e Sekretariatit të UNFCCC.

Po ashtu, plani reflekton udhëzimet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian, përfshirë Kornizën e Strategjisë së BE-së për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe dokumentet udhëzuese të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA).

Nga vlerësimi i bërë, rezulton se projektakti është tërësisht në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, nuk përmban dispozita që bien ndesh me Kushtetutën apo aktet ligjore në fuqi, dhe përbën një hap të domosdoshëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional të vendit për përballjen me sfidat e ndryshimeve klimatike.

Sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis të këtij Plani, referuar VKM Nr. 507, datë 10.6.2015 “Për miratimin e listës së detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative në mjedis, që do t’i nënshtrohen procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor”, Plani Kombëtar i Përshtatjes nuk është i përfshirë në listën e planeve apo programeve që parashikohen shprehimisht për t’iu nënshtuar procedurës së VSM. NAP është një plan kombëtar orientues, i cili përcakton kuadrin e përgjithshëm të politikave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, pa miratuar projekte specifike apo investime infrastrukturore të drejtpërdrejta. Masat e parashikuara në Plan përbëhen nga gjithsej 45 masa, prej të cilave 15 janë masa “light”, kryesisht masa të buta dhe masa të bazuara në natyrë (Nature-Based Solutions), që synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e planifikimit, menaxhimin e rreziqeve klimatike, mbrojtjen e ekosistemeve dhe rritjen e qëndrueshmërisë së komuniteteve ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur në thelb një ndikim të pritshëm pozitiv në mjedis, ndërkohë që mosmarrja e veprimeve të përcaktuara në Plan, sipas analizës financiare, do të sillte pasoja negative mjedisore dhe kosto më të larta ekonomike në afatmesëm dhe afatgjatë. Ndërkohë, 6 masat infrastrukturore të parashikuara në NAP nuk përbëjnë masa të reja të projektuara nga ky plan, por rrjedhin nga dokumente sektoriale ekzistuese, si strategjitë e transportit, energjisë, zhvillimit urban dhe ujërave, dhe për çdo projekt konkret që do të buronte prej tyre, do të zbatohen procedurat përkatëse të VNM ose VSM, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar kështu vlerësimin e plotë të ndikimeve mjedisore në nivel plani apo projekti.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRES* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka si objekt përafrimin e drejtpërdrejtë të legjislacionit shqiptar me *acquis* të Bashkimit Evropian, pasi NAP 2026-2036 përbën një dokument politik-strategjik kombëtar dhe jo një akt normativ që transponon apo harmonizon *acquis* të BE-së. Megjithatë, përmbajtja dhe orientimi i planit janë në përputhje të plotë me parimet dhe drejtimet e përgjithshme të politikave klimatike të Bashkimit Evropian, si dhe me detyrimet e vendeve anëtare dhe vendeve candidate për hartimin e dokumenteve strategjike të përshtatjes sipas

Udhëzimeve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Plani reflekton objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Bashkimit Evropian për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, si dhe në Rregulloren (BE) 2018/1999 për Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimin për Klimën, e cila kërkon nga shtetet anëtare përgatitjen e planeve kombëtare të përshtatjes dhe funksionimin e një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit dhe raportimit të progresit. Projektakti n mbështet procesin e përgjithshëm të përafrimit me kapitullin 27 të acquis, duke kontribuar në afrimin e Shqipërisë me praktikrat dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e planifikimit, menaxhimit të rreziqeve klimatike dhe forcimit të qëndrueshmërisë.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTI

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026–2036” ka për qëllim miratimin e dokumentit kryesor strategjik në fushën e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, i cili orienton politikëbërjen kombëtare dhe ndërsektoriale për një periudhë 10-vjeçare. Ky plan përshkruan vizionin, objektivat strategjike, prioritetet, masat dhe mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional që synojnë rritjen e qëndrueshmërisë së vendit ndaj rreziqeve dhe ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Projektakti parashikon miratimin e NAP 2026-2036, përfshirë masat sektoriale dhe ndërsektoriale për pesë sektorët prioritarë të identifikuar në procesin e vlerësimit të rrezikut klimatik: bujqësinë, energjinë, transportin, turizmin dhe zhvillimin urban.

Në përmbajtjen e projektvendimit është përfshirë detyrimi për hartimin dhe paraqitjen nga Ministria përgjegjëse për mjedisin të një raporti monitorimi çdo dy vjet, për të siguruar vlerësimin e vazhdueshëm të progresit dhe për të evidentuar sfidat dhe nevojat për përmirësime si dhe për të përmbushur detyrimet për raportim në Sekretariatit të Energjisë, UNFCCC në platformën ETF. Po ashtu, projektakti parashikon që Plani të i nënshtrohet një rishikimi të detyrueshëm në mes të periudhës së zbatimit, si dhe rishikimeve të pjesshme ose të plota sa herë që kërkohet nga zhvillimet shkencore, teknologjike ose nga detyrimet e reja ndërkombëtare dhe të BE-së.

Projektvendimi përcakton gjithashtu detyrimin për dorëzimin e dokumentit të Planit Kombëtar të Përshtatjes në Sekretariatit e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, në përputhje me detyrimet e Shqipërisë sipas kornizës së Transparencës së Përmirësuar (ETF) dhe raportimeve të përcaktuara nga UNFCCC.

Në zbatim të këtij vendimi, ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore të përmendura në Planin Kombëtar të Përshtatjes, të cilat do të kontribuojnë në realizimin e masave përkatëse brenda kompetencave të tyre dhe në koordinim me Ministrinë përgjegjëse për mjedisin. Miratimi i këtij projektvendimi krijon bazën e nevojshme për planifikimin afatgjatë të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, duke garantuar një qasje të koordinuar, koherente dhe të harmonizuar me standardet dhe praktikat e Bashkimit Evropian.

Projektvendimi “Për miratimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike” përbëhet nga 3 pika,, ku në pikën 1, parashikohet miratimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036, i cili përbën një dokument strategjik, të strukturuar në disa kapituj tematikë, të cilët trajtojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat, nevojat dhe veprimet prioritare për rritjen e qëndrueshmërisë klimatike të Shqipërisë.

Në pikën 2 parashikohen institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi dhe në pikën 3 të tij, parashikohet shfuqizimi i Kapitullit 6 “Plani kombëtar i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike” i Vendimit nr. 466, datë 3.7.2019 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”, pasi pjesa e shfuqizuar trajtohet në këtë vendim dhe nuk është më pjesë e VKM 466/2019.

Plani Kombëtar përbëhet nga 10 kapituj dhe Shtojca.

Dokumenti hapet me Parathënien dhe Përmbledhjen Ekzekutive, ku paraqiten qëllimi, logjika e përgjithshme e planit dhe përfitimet kryesore të tij për vendin. **Kapitulli i parë** jep hyrjen në kontekstin e ndryshimeve klimatike dhe rolin e Planit Kombëtar të Përshtatjes në kuadrin kombëtar të politikave.

Kapitulli i dytë paraqet konceptet bazë të përshtatjes, procesin e hartimit të NAP-it dhe përvojat ndërkombëtare dhe kombëtare që kanë orientuar zhvillimin e këtij dokumenti.

Kapitulli i tretë analizon kontekstin socio-ekonomik dhe institucional të vendit, përfshirë popullsinë, treguesit makroekonomikë, sektorët kryesorë të zhvillimit si dhe kuadrin ligjor e politik që lidhet me përshtatjen.

Më tej, **kapitulli i katërt** trajton tendencat dhe skenarët klimatikë, si dhe vlerësimet e cenueshmërisë dhe rreziqeve klimatike në nivel kombëtar, sektorial dhe vendor.

Kapitulli i pestë fokusohet në identifikimin e masave të përshtatjes, duke paraqitur ndërhyrjet në nivel sektorial e vendor dhe duke përcaktuar veprimet prioritare që kërkojnë zbatim të menjëhershëm ose afatmesëm.

Kapitulli i gjashtë paraqet planin e zbatimit të NAP-it, përfshirë masat prioritare, qeverisjen dhe përgjegjësitë institucionale, afatet, si dhe kostot e planifikuara për ekzekutimin e planit.

Kapitulli i shtatë, përqendrohet në integrimin e perspektivës gjinore, duke analizuar sfidat e barazisë gjinore dhe duke propozuar veprime konkrete për sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të drejtë gjinore në të gjithë procesin e përshtatjes.

Kapitulli i tetë trajton komunikimin dhe angazhimin e palëve të interesit, duke përcaktuar objektivat, audiencat, mesazhet kryesore dhe planin e veprimit për përfshirjen aktive të aktorëve relevantë.

Kapitulli i nëntë analizon aspektet e financimit të përshtatjes, duke vlerësuar nevojat financiare, boshllëqet ekzistuese, pengesat, mekanizmat mundësues dhe qasjet strategjike për të siguruar fonde adekuate për zbatimin e NAP-it.

Kapitulli i dhjetë i kushtohet sistemit të monitorimit, vlerësimit dhe të nxënit, duke paraqitur kuadrin e rezultateve, mekanizmat e monitorimit, metodat e vlerësimit dhe proceset mbështetëse për mësimin institucional dhe përshtatjen e vazhdueshme të politikave.

Dokumenti mbyllet me një grup aneksesh teknikë të cilët përfshijnë kuadrin rregullator, të dhëna të detajuara mbi tendencat klimatike, planin e detajuar të zbatimit dhe informacione mbështetëse që shërbejnë për zbatimin praktik të planit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen institucionet qendrore dhe vendore që kanë rol të drejtpërdrejtë në planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e masave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Institucioni kryesor përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e procesit mbetet Ministria përgjegjëse për mjedisin, mbështetur nga institucionet e varësisë së saj, si: Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve .

Zbatimi i masave sektoriale të përcaktuara në plan kërkon angazhimin e ministrive linjë, përfshirë ministrinë përgjegjëse për bujqësinë, ministrinë

përgjegjëse për turizmin, ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen civile dhe institucionet e tjera sektoriale në varësi të fushëveprimit të tyre. Njësitë e qeverisjes vendore janë aktorë kyç në zbatimin e masave të përshtatjes në nivel lokal, veçanërisht për sa i përket planifikimit të territorit, menaxhimit të burimeve natyrore, infrastrukturës vendore dhe masave të reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë.

Procesi kërkon gjithashtu bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Agjencinë Kombëtare të Burimeve Ujore, Institutin e Gjeoshkencave, (IGJEO), dhe institucionet kërkimore akademike që mbështesin vlerësimet e rrezikut dhe analizat teknike.

Nëpërmjet angazhimit të koordinuar të këtyre institucioneve sigurohet realizimi i masave të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike 2026-2036 dhe funksionimi efektiv i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të progresit në nivel kombëtar dhe vendor.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria përgjegjëse për mjedisin, përmes Dretorisë së Klimës dhe mbështetjen e UNDP Shqipëri përmes projektit “Avancimi i planifikimit të Shqipërisë për përshtatje afatmesme dhe afatgjatë përmes zhvillimit të një procesi të Planifikimit Kombëtar të Përshtatjes (NAP)”, ka udhëhequr procesin e hartimit të këtij projektakti, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga ligji nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike” i ndryshuar dhe angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare në drejtim të planifikimit të përshtatjes.

Hartimi i dokumentit është mbështetur nga ministritë linjë përkatëse, përfshirë institucionet përgjegjëse për bujqësinë, turizmin, energjinë, infrastrukturën, shëndetësinë, menaxhimin e burimeve ujore dhe mbrojtjen civile, të cilat kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në definimin e masave sektoriale të përshtatjes. Njësitë e qeverisjes vendore kanë ofruar informacion në kuadër të proceseve të hartimit të planeve vendore të përshtatjes dhe vlerësimit të cënueshmërisë klimatike.

Procesi është mbështetur edhe nga institucione akademike dhe kërkimore, përfshirë IGJEO dhe ekspertë të tjerë shkencorë që kanë asistuar në vlerësimin e rreziqeve klimatike, modelimin dhe analizat teknike në bashkëpunim me

ekspertët e kontraktuar nga UNDP. Organizatat ndërkombëtare dhe partnerët zhvillimorë, kanë kontribuar në dhënien e informacionit lidhur me financimet e parashikuara për investime në fushën e përshtatjes.

Projektvendimi u publikua në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në datë 26.11.2025 dhe është marrë 1 koment nga UNICEF, për përfshirjen e disa masave të përshtatjes në Planin e Zbatimit (Aneksi III), të cilat pasqyrojnë qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve, si vijon:

- Masa e Përshtatjes 6: Rritja e ndërgjegjësimit për qëndrueshmërinë klimatike dhe ofrimi i trajnimeve mbi masat e përshtatjes dhe zbutjes, përfshirë zhvillimin e moduleve të synuara të trajnimit për profesionistët, institucionet publike, bashkitë dhe ofruesit e shërbimeve kritike, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit në nivel komuniteti mbi rreziqet klimatike kryesore.
- Masa e Përshtatjes 10: Edukimi në komunitet – përshtatja dhe rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet nga fatkeqësitë, përfshirë zhvillimin e materialeve edukative të përshtatshme për moshën për shkollat fillore dhe të mesme, si dhe organizimin e aktiviteteve komunitare të ndërgjegjësimit. UNICEF inkurajon përfshirjen e edukimit të qëndrueshëm ndaj klimës dhe reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë në arsimin formal dhe joformal, duke siguruar që fëmijët dhe adoleshentët të pajisen me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për t'u përshtatur me një klimë në ndryshim.
- Masa e Përshtatjes 4: Forcimi i kapaciteteve të qëndrueshmërisë klimatike përmes përmirësimit të sistemeve të të dhënave, e cila paraqet një mundësi të rëndësishme për forcimin e përdorimit të të dhënave klimatike të ndara sipas moshës dhe të ndjeshme ndaj fëmijëve.

Komenti është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në tekstin e Dokumentit.

Projektvendimi do të dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet në Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe në Agjencinë për Mbështetjen e Vetqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ndryshimet klimatike po shkaktojnë dëme të konsiderueshme ekonomike dhe fiskale në Shqipëri, duke rritur nevojën për masa të strukturuar dhe të financuara të përshtatjes.

Në këtë kontekst, NAP 2026–2036 dhe “Strategjia e Financimit të NAP-it” përbëjnë instrumentet kryesore të planifikimit për të orientuar dhe justifikuar alokimet buxhetore të nevojshme për reduktimin e risqeve klimatike. Strategjia është hartuar në përputhje me prioritetet e NAP-it, duke adresuar në mënyrë të posaçme implikimet fiskale, nevojat për investime dhe burimet e mundshme të financimit.

Vlerësimi i kostove të përshtatjes identifikon 66 masa prioritare në sektorët bujqësi/pyje, turizëm, energji, transport, zhvillim urban dhe masa ndërsektoriale, me një kosto totale të vlerësuar prej 9.8 miliardë USD deri në vitin 2036. Procesi i prioritizimit është mbështetur në analiza shumëkriterëshe (ASHK) dhe analiza kosto-përfitim (AKP), duke identifikuar investimet me efektivitet më të lartë në reduktimin e rrezikut dhe në rritjen e elasticitetit klimatik.

Struktura e masave të përshtatjes dhe implikimet buxhetore

Plani përfshin 66 masa prioritare, të ndara në tre kategori kryesore sipas natyrës së shpenzimeve dhe nivelit të investimeve:

- Masat e buta (45 masa): Analiza të riskut, sisteme informacioni, instrumente rregullatore, ngritje kapacitetesh dhe mekanizma financiarë. Këto masa kërkojnë shpenzime operative të ulëta, por janë kritike për funksionimin e infrastrukturës së politikave klimatike dhe për bazën institucionale të masave kapitale.
- Masat e gjelbra (15 masa): Restaurim ekosisteme, ripyllëzim, teknikat agroekologjike dhe zgjidhjet e bioinxhinierisë. Këto masa gjenerojnë përfitime afatgjata fiskale dhe përfaqësojnë pjesën më të rëndësishme të investimeve kapitale të NAP-it.
- Masat gri (6 masa): Infrastrukturë ripërtëritëse, sistemet e kullimit, rezervuarë, mure mbrojtëse dhe teknologji mbrojtëse ndaj ngjarjeve ekstreme. Kostoja është më e lartë, duke justifikuar pjesën më të madhe të buxhetit kapitale.

-

Dimensionimi sektorial i masave dhe kosto

Për të orientuar qartë ndarjen buxhetore, masat klasifikohen sipas sektorëve kryesorë, ku secili sektor paraqet modele shpenzimi të ndryshme:

- Masat ndërsektoriale (10 masa) fokusohen në sisteme të të dhënave klimatike, koordinim rajonal, forcim institucional dhe instrumente novatore financimi (si fondet rajonale dhe modelet pilot të financimit të përzier). Këto kërkojnë kryesisht shpenzime operative dhe janë thelbësore për funksionimin e gjithë arkitekturës së NAP-it.
- Bujqësia (8 masa) përfshin investime në rehabilitimin e ujitjes/kullimit, mbledhjen e ujit të shiut, zgjidhje të bazuara në natyrë në tokat bujqësore dhe mekanizma financiarë për mbrojtjen e fermerëve (fondet e kompensimit, sigurimi i kulturave). Për shkak të natyrës së infrastrukturës bujqësore, këto masa kërkojnë si investime kapitale ashtu edhe mbulim të rrezikut fiskal.
- Pyjet (13 masa) përqendrohet në ripyllëzim në shkallë të gjerë, programe të restaurimit të pellgjeve ujëmbledhëse, fidanishte për specie rezistente, restaurim bregdetar/lumor dhe skema PSHE. Ky sektor përbën një nga komponentët me koston më të lartë nga masat gjelbra, duke justifikuar kërkesën për fonde të konsiderueshme afatgjata.
- Turizmi (11 masa) janë kryesisht masa të buta, që kërkojnë financime të ulëta – planifikim hapësinor, standarde ndërtimi, rregullore të menaxhimit të rrezikut klimatik, ngritje kapacitetesh, qendra të njohurive digjitale dhe ndërhyrje të kufizuara ekosistemike (p.sh., mbrojtja e trashëgimisë nënujore). Ky sektor ka potencial të lartë për financim nga donatorët dhe sektori privat, duke reduktuar ekspozimin e buxhetit të shtetit.
- Zhvillimi urban (9 masa) përfshin integrimin e klimës në planifikimin urban, vlerësimet e riskut klimatik në qytete, planet e emergjencave, gjelbërimin urban dhe korridoret e gjelbra. Shpenzimet janë të përziera, me komponentë të rëndësishëm kapitalë për infrastrukturën urbane.
- Energjia (8 masa) fokusohen në mbrojtjen e infrastrukturës energjetike, përmirësimin e operacioneve të hidrocentraleve, standardet e efikasitetit të energjisë dhe menaxhimin e kërkesës. Masat gri në këtë sektor justifikojnë investime kapitale të larta për të shmangur dëme shumëfish më të mëdha në rast ngjarjesh ekstreme.
- Transporti (7 masa) përfshin vlerësime të rrezikut, zgjidhje bioinxhinierike për stabilizimin e rrugëve, standarde të reja të projektimit dhe partneritete financiare. Këtu, investimet janë një kombinim i “butë”, “gjelbër” dhe “gri”,

por disa ndërhyrje gri (veçanërisht mbrojtja e segmenteve kritike rrugore) përbëjnë një pjesë të rëndësishme të boshllëkut financiar.

Masa të infrastrukturës së gjelbër dhe gri (21 masa) përfaqësojnë pjesën më të madhe të kostos totale, ku pesë ndërhyrje kryesore përbëjnë rreth 80% të investimit total të planifikuar.

Kostot e parashikuara për planin e zbatimit

Në total, do të nevojiten rreth 9.8 miliardë dollarë amerikanë për zbatimin e 66 ndërhyrjeve për përshtatje, siç përcaktohet përmes analizës së detajuar të kostos. Këto kosto janë shpërndarë midis masave ndërsektoriale dhe sektoriale të planifikuara në këtë Plan Zbatimi të NAP-it, siç paraqitet në tabelën më poshtë, në rend zbritës të kostos:

Totali i masave dhe kostove për sektor.

Sektori	Nr. i masave	% e masave	Kostoja (Dollarë amerikanë)	% e kostos
Zhvillimi urban	9	13%	2.723.161.544	28%
Pylltari	13	20%	2.134.799.556	21%
Transporti	7	11%	2.038.835.000	21%
Energjia	8	12%	1.960.573.000	20%
Bujqësia	9	13%	678.114.861	7%
Ndërsektoriale	10	15%	256.721.396	2%
Turizmi	11	16%	8.491.619	1%
GJITHSEJ	66	100	9.800.696.976	100

Zhvillimi urban ka koston më të lartë të përlogaritur (me 9 masa), i ndjekur nga pyjet (13 masa) dhe transporti (7 masa), ndërsa turizmi ka koston më të ulët të përlogaritur me 11 masa.

Nevojat e vlerësuara për buxhet sipas llojit të ndërhyrjes.

Masat “gjelbra” përbëjnë 45% të kostove totale (15 masa), ndërsa masat “gri” përbëjnë 23% të kostove (6 masa). Masat “e buta” përbëjnë 32% të kostove, por përbëjnë 68% të numrit të masave.

Lloji i ndërhyrjes	Kostot e përlogaritura (Dollarë amerikanë)	Kostot e përlogaritura (%)	Nr. i masave të përshtatjes	Masat e përshtatjes (%)
Ndërhyrja e gjelbër	4.410.400.115	45%	15	23%
Ndërhyrje e butë	3.152.953.700	32%	45	68%
Ndërhyrje gri	2.237.343.161	23%	6	9%
Totali i përlogaritur	9.800.696.976	100%	66	100%

Ndarja sipas kohës së zbatimit

Masat janë planifikuar për të filluar në periudha të ndryshme bazuar në kompleksitetin, burimet e nevojshme dhe përgatitjet e kërkuara:

Periudha kohore	Planifikimi/angazhimet e buxhetit		Propozimi për përlogaritjen vjetore të buxhetit (disbursimet)	
	Buxheti i përlogaritur për datën e fillimit të masës (dollarë amerikanë)	Numri i masave	Disbursimet e përlogaritura (dollarë amerikan)	% e buxhetit të përgjithshëm
Afatgjatë (2033-2036)	3.017.008.804	10	6,649,179,967 (disbursimet përfundojnë në vitin 2042)	68%
Afatmesme (2029-2032)	3.637.373.692	18	2.609.730.508	27%
Afatshkurtër (2026-2028)	3.146.314.481	38	541.786.502	6%
Totali i përlogaritur	9.800.696.977	66	9.800.696.977	100%

Gjithashtu, në tabelë merret parasysh koha e shpërndarjes së buxhetit, e cila mund të shtrihet përtej periudhës zyrtare të Planit, pasi shumë masa zgjasin nga 2 deri në 10 vjet. Për shembull, për një projekt që fillon në vitin 2028 dhe zgjat dhjetë vjet fondet miratohen herët, por disbursimet shpërndahen nga periudha e hershme, e mesme dhe e vonë, deri në vitin 2042, kur pritet të përfundojnë projektet përfundimtare. Pas vitit 2036, nuk fillon asnjë masë e re dhe ky është fundi i ciklit të planifikimit.

Sa i përket totalit të disbursimeve, ato shpërndahen në kohë si më poshtë:

- Periudha afatgjatë: 68% e fondeve të përgjithshme ($\approx$ 6.65 miliardë dollarë amerikanë), që mbulojnë projekte që kanë filluar ose që vijnë në këtë fazë.
- Periudha afatmesme: 27% e fondeve të përgjithshme ($\approx$ 2.61 miliardë dollarë amerikanë), duke mbështetur shkallëzimin e përpjekjeve të përshtatjes.
- Periudha afatshkurtër: 6% e fondeve të përgjithshme ($\approx$ 541.79 milionë dollarë amerikanë), duke paraqitur një fillim me faza të përqendruar në veprime të shpejta dhe themelore.

Në përgjithësi, strategjia e financimit e Planit Kombëtar të Përshtatjes ndjek një qasje graduale dhe me faza, duke i dhënë përparësi fillimisht masave të buta dhe urgjente, të cilat krijojnë bazën institucionale, teknike dhe ligjore për zbatimin e

investimeve të mëdha strukturore në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Miratimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes është kusht thelbësor për funksionalizimin e kësaj qasjeje, pasi pa një dokument strategjik të miratuar zyrtarisht, masat e përshtatjes nuk mund të njihen si prioritete kombëtare dhe për rrjedhojë, nuk mund të jenë të pranueshme për financim nga mekanizmat ndërkombëtarë të klimës. Institucionet financiare ndërkombëtare dhe mekanizmat si Green Climate Fund (GCF), Global Environment Facility (GEF), fondet e Bashkimit Europian, si dhe programet e OKB-së, kërkojnë që masat të jenë të parashikuara në dokumente strategjike kombëtare të miratuara, si NAP, për të garantuar koherencë politike, pronësi kombëtare dhe qëndrueshmëri afatgjatë të investimeve. Në këtë kuadër, mosmiratimi i Planit do të kufizonte ndjeshëm aftësinë e Shqipërisë për të përthithur financime ndërkombëtare dhe do ta zhvendoste barrën e financimit pothuajse tërësisht mbi buxhetin e shtetit.

Vlerësimi i boshllëkut financiar evidenton një mungesë totale prej rreth 9.1 miliardë USD, me diferenca të konsiderueshme ndërsektoriale: zhvillimi urban (2.7 mld USD), transporti (2.3 mld USD), pyjet (1.93 mld USD), energjia (1.66 mld USD), bujqësia (0.52 mld USD) dhe masat ndërsektoriale (0.25 mld USD), ndërkohë që sektori i turizmit paraqet një tepriçë të vogël financiare prej rreth 6 milionë USD. Financimi i angazhuar deri më tani përfshin rreth 300 milionë USD fonde publike nga Qeveria Shqiptare, të parashikuara në Programin Buxhetor Afatmesëm (2026–2028) dhe në strategjitë sektoriale, si dhe rreth 400 milionë USD nga financat ndërkombëtare dhe investimet private. Këto shifra tregojnë qartë se buxheti kombëtar mbulon vetëm një pjesë shumë të kufizuar të nevojave reale për përshtatje dhe se mbështetja në financimin ndërkombëtar nuk është një alternativë, por një domosdoshmëri strategjike.

Siç është argumentuar më sipër, gjatë tre viteve të para të zbatimit janë parashikuar kryesisht kosto për masat “soft”, të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e planifikimit sektorial dhe integrimin e përshtatjes në politikat ekzistuese. Këto masa janë thelbësore për të siguruar që ndërhyrjet e ardhshme infrastrukturore dhe investimet e mëdha të jenë të projektuara në mënyrë të qëndrueshme dhe të pranueshme për financim ndërkombëtar. Në këtë kontekst, miratimi i Planit Kombëtar të Përshtatjes nuk është vetëm një detyrim politik dhe strategjik, por një parakusht për aksesimin e fondeve nga GCF, GEF, BE, OKB dhe mekanizma të tjerë, duke e shndërruar Planin në instrumentin kryesor që lidh prioritetet kombëtare me mekanizmat globale të financimit klimatik.

Strategjia e financimit propozon një strukturë të kombinuar financimi, duke shfrytëzuar:

- financat publike vendase (buxhetet kombëtare dhe lokale);
- fondet ndërkombëtare për klimën (FGJK, GEF, Fondi i Përshtatjes, IPA, MDB-të);
- sektorin privat përmes partneriteteve publik-private dhe investimeve direkte;
- instrumentet inovative (obligacione të gjelbra, financim të përzier, instrumente të bazuara në rezultate, skema sigurimi të risqeve klimatike).

Modeli financiar parashikon mobilizimin e të paktën 20% të fondeve nga burimet vendase deri në vitin 2036, krahas zgjerimit të rolit të FGJK-së si partneri kryesor i financimit.

Për minimizimin e risqeve fiskale, strategjia përfshin mekanizma të menaxhimit financiar të katastrofave, si sigurimi i bujqësisë dhe pronës, fondet e emergjencës dhe linjat e kreditit të kushtëzuara me ngjarje ekstreme klimatike, të cilat synojnë të shmangin goditjet fiskale të menjëhershme dhe vonesat në zbatimin e projekteve të përshtatjes.

Mekanizmi i monitorimit, vlerësimit dhe të nxënies (MVN) siguron gjurmim të alokimeve buxhetore dhe burimeve të mobilizuara, duke përdorur indikatorë fiskalë të qartë: financimi i mobilizuar sipas burimit, vlera e disbursimeve vjetore, progresi në mbylljen e boshllëkut financiar, numri dhe shkalla e zbatimit të projekteve të financuara. Rishikimet vjetore dhe vlerësimi afatmesëm të lidhura me ciklin buxhetor dhe me raportimin e NAP-it garanton adaptimin e vazhdueshëm të strategjisë.

Në terma justifikimi buxhetor, strategjia e financimit demonstroi se kostoja e mosveprimit (deri në 7% të PBB-së) tejkalon ndjeshëm koston e investimeve të kërkuara.

MINISTRI

SOFJAN JAUPAJ

